

DWP CREATIONS

THIRRJE PËR
PROJEKTE ARTISTIKE

CALL FOR ARTISTIC
PROJECTS

POZIV ZA UMETNIČKE
PROJEKTE

Afati i fundit për aplikim /
Application deadline /
Krajnji rok za prijavljivanje

16.01.2023

DWP CREATIONS

THIRRJE PËR APLIKIM

Thirrje për projekte artistike

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë ka kënaqësinë të ftojë artistët e rinj të cilët veprojnë në fusha të ndryshme të artit që të aplikojnë në thirrjen e dytë për mbështetje të veprave artistike.

Për të gjithë ata artistë të cilët dëshirojnë të zhvillojnë vepra që përkujtojnë viktimat/ngjarjet e kohës së luftës dhe adresojnë një çështje të veçantë në drejtësinë tranzicionale, i inkurajojmë të aplikojnë në këtë thirrje me qëllim zhvillimin e formave të ndryshme dhe të reja artistike duke u fokusuar në ballafaqimin me të kaluarën.

Artistët që aplikojnë i nxisim që të kenë parasysh gjendjen aktuale, përfshirë konfliktet ekzistuese kudo në botë, në krijimin e veprave që ndërlidhen me kujtimet e tyre apo reflektimet mbi të kaluarën tragjike të Kosovës.

Rreth projektit:

DwP Creations është projekt i mbështetur nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe National Endowment for Democracy me qëllimin e zhvillimit të formave të reja artistike të cilat merren me ballafaqimin me të kaluarën duke mbështetur artistë, shkrimtarë, antropologë, punëtorë në kulturë, gazetarë e të tjerë në realizimin e ideve të tyre.

Përgjatë tri viteve do të hapen 6 thirrje për projekte drejtuar të gjitha grupeve dhe komuniteteve etnike në Kosovë dhe në rajon. Kandidatët e suksesshëm do të punojnë ngushtë me FDHK-në për të zhvilluar dhe prodhuar veprën artistike, ku stafi do t'i ndihmojë me informacione dhe udhëzime të nevojshme, duke siguruar saktësinë faktike të ideve.

Veprat e krijuara do të ekspozohen në Qendrën e Dokumentimit Kosovë.

Për të aplikuar, plotësojeni formularin për aplikim dhe dërgoni atë bashkë me dokumentet e tjera të kërkuara, në emailin: info.dckosovo@gmail.com me titull: Aplikimi për DwP Creations.

Afati i fundit për aplikim: 16.01.2023

Për çfarëdo pyetje apo informacioni shtesë, ju lutem na kontaktoni në info.dckosovo@gmail.com.

DWP CREATIONS FORMULARI PËR APLIKIM

Kush mund të aplikojë?

Thirrja është e hapur për të gjithë artistët/et të fushave të ndryshme pavarësisht përkatësisë së tyre gjinore, etnike etj;

Artistët duhet të kenë njohuri rreth të kaluarës dhe historisë së Kosovës;

Mund të aplikojnë artistët vizuel, performues, kineastë, shkrimtarë, fotografë dhe të tjerë të cilët punojnë në këtë fushë;

Mund të aplikojnë edhe kolektivet artistike;

Aplikacionet pranohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze;

Informatat e përgjithshme

Emri, mbiemri i artistit/ëve	
Adresa	
Nr. i telefonit	
Profesioni	
Ditëlindja	
Email adresa	
Website (nëse ka)	

DWP CREATIONS FORMULARI PËR APLIKIM

Informata për veprën artistike

1. Përshkrimi i projektit (jo më shumë se 300 fjalë):

2. Titulli i projektit:

3. Kohëzgjatja dhe fazat e zhvillimit të projektit
(plani i punës duhet të përmbajë nisjen, zhvillimin dhe përfundimin e projektit):

4. Shpjegoni se si lidhet projekti juaj me temën e thirrjes:

5. Qëllimi i idesë dhe si kontribuon ajo në ballafaqimin me të kaluarën:

6. Rezultatet që i prisni nga projekti juaj;

7. Cilën audiencë e synoni dhe arsyet:

DWP CREATIONS

FORMULARI PËR APLIKIM

Buxheti

	Përshkrimi i shpenzimit	Njësia	Numri i njësive	Kosto (në euro)	Totali (në euro)
TOTAL					

Ju lutemi shtoni kolona nëse ju duhet. Buxheti nuk duhet të kalojë shumën totale prej 3000 euro.

Në mënyrë që aplikimi juaj të konsiderohet i kompletuar ju lutem dërgoni:

- Formularin për aplikim i plotësuar;
- CV (portofolio, nëse keni);
- Në e-mailin e aplikimit mund të bashkëngjitni edhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me idenë tuaj

DWP CREATIONS

THIRRJE PËR PROJEKTE ARTISTIKE



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

DCKK



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD